

**RUZHDI STRINGA\***

**KINIZMAT DHE KALKIMET ME PËRMBAJTJE KINEZE  
NË LETRAT SHQIPE NË ROMANET “KONCERT NË FUND  
TË DIMRIT” (I. KADARE) DHE “DRAGOI I FILDISHTË”  
(F. KONGOLI) E NDONJË TJETËR**

Kur përmend letra të shkruara, nisur nga qëllimi i vënë që në titull, do të mbaj parasysh fillimisht letërsinë, dhe pastaj lajmëtarinë. Veprat letrare lexohen më shumë për kënaqësi, por edhe për njohuri, më pak për informim; lajmet lexohen, në përgjithësi, për t'u informuar. Këtë nuk e them unë i pari, mirëpo është edhe shumë evidente. Pavarësisht shmangieve nga synimi, që shpesh vërehen, të dyja këto zbatime të gjuhës standard edukojnë gjuhësisht dhe prandaj mund të flasim për kulturë gjuhe dhe përdorues të kulturuar. Por më duhet të theksoj se në terrenin e shqipes gjuha e letërsisë nuk paraqitet aq e hapur dhe e çlirët, ndërsa gjuha e informimit ka mbetur tepër e mbyllur dhe e ngurtësuar normativisht, duke bërë që sistemi i standardit, i dhënë përmes këtyre dy strukturave hierarkike të zbatimit të vet, të gëzojë në vazhdimësi bashkëkohëzim. Nisur nga përkufizimi i mëposhtëm do ta marr për të mirëqenë faktin se gjuha e letërsisë dhe gjuha e informimit janë dy nga zbatimet kryesore edhe të gjuhës standarde shqipe:

varieteti me statusin më të lartë i gjuhës së një komuniteti ose kombi, i cili zakonisht mbështetet në ligjërimin e folur dhe të shkruar të përdoruesve të arsimuar vendës të kësaj gjuhe. Gjuha standarde përdoret përgjithësisht në median informative, në letërsinë artistike, në fjalorë dhe gramatika, në shkollë dhe për mësimin e saj si gjuhë e huaj. Ndonjëherë është varieteti i kulturës, i përdorur në qendrat politike dhe kulturore të një vendi, p.sh. gjuha standarde e Francës mbështetet në frëngjishten e parizianëve të arsimuar.... Është një varietet relativisht i njësuar i gjuhës që përdoret për komunikim brenda vendit. Gjuha standarde është rezultat i përpjekjeve afatgjata linguistike dhe normëzuese të institucioneve kulturore, si akademitë dhe i botimeve të tilla, si fjalorë, gramatika, ku më tepër parapëlqehen format e shkruara se ato bisedore e dialektore. Kodifikimi i gjuhës standarde mund të

---

\* Specialist i gjuhës shqipe në Beijing Foreign Studies University, School of European Languages and Cultures, Albanian Language Department.

bëhet në nivele të ndryshme: në drejtshkrim, drejtshqiptim, gramatikë dhe leksik. Në lëmin e terminologjisë teknike, marrëveshjet zyrtare midis specialistëve të fushave të ndryshme mund të drejtojnë standardizimin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për më tepër: Trudgill 1983, Wardhaugh 1986, Woods 1985, Zgusta 1989, Milroy 1991, McArthur 1992, Bauer 1994.<sup>1</sup>

Kështu lloji i gjuhës së përdhyer, të errët apo “të madhe”, ajo gjuhë që gjallon në të gjitha format/paradigmat sociale, kulturore, gjeografike, përndryshe mënyra e tërthortë e shprehjes, shumëkuptimësia, konotimi, figuracioni etj. janë thelbësore te gjuha e letërsisë/letrare, kurse gjuha e rrafshët/e pastër apo “e vogël”, ajo që i vlen drejtpërdrejtë marrëveshjes kuptimore është detyrim te gjuha e informimit/zyrtare. Nëse lexojmë për qëllime studimi në këto dy zbatime të gjuhës standarde shqipe, do të shohim se “gjuha e madhe” gjithnjë e më shumë po e nxjerr jashtëloje “gjuhën e vogël”. Ky është, përveç të tjerave, një tipar i gjuhës në tranzicion<sup>2</sup>. Ky tranzicion gjuhësor jo vetëm mban pezull çështje gjuhësore që i bie koha e re, por edhe diskuton asish të kohës së kaluar. Për të mbetur te i njëjti diskutim teorik, dhe për t’u orientuar disi në shumësinë e termave grupfjalëshe me fjalë kokë *gjuhë*, si *gjuhë letrare kombëtare*, *gjuhë e përbashkët*, *gjuhë mbidialektore*, *gjuhë zyrtare* etj. unë, sipas parashtrimit të mësipërm, do të veçoja dy terma dallues brenda gjuhës standarde shqipe: për gjuhën e madhe etj. termin *gjuhë e letërsisë/letrare* dhe për gjuhën e vogël etj. termin *gjuhë e informimit/zyrtare*. Kështu, brenda standardit do të kishim rrethin e madh të gjuhës së letërsisë dhe brenda këtij rrethin e vogël të gjuhës së lajmit, ku e para mund të lidhej me strukturat e tërthorta dhe e dyta me strukturat e drejtpërdrejta të komunikimit.

Në rrjedhën e 40 vjetëve që vijuan rëndësia e rolit të transformimeve erdhi duke u ulur si rrjedhojë e punës brenda dhe jashtë formulimeve origjinale të Chomsky-t; një gjë e tillë i detyrohet futjes së konceptit “të strukturave të thella”, mbi të cilat u pohua se vepronin transformimet (dhe, të paktën në bazë të disa formulimeve, ende pohohet se vepronin), për të krijuar strukturat sipërfaqësore...<sup>3</sup>

Gjuha letrare do të ishte gjuha e veprave letrare: me prirje pasuruese, e përdhyer, shumëkuptimëshe, e errët - për ç’arsye edhe “e pakuptimtë”, e hapur

<sup>1</sup> gjuhë standard: *Longman Dictionary of Language Teaching & Applied Linguistics*, English-Chinese edition 1998.

<sup>2</sup> Shih për më tepër: në revista “elite”, dhjetor 2015, R. Stringa, *Gjuhëtari përtej aziatikut*.

<sup>3</sup> R. H. Robins, *Historia e Gjuhësisë*, përktheu Genc Lafe, Shtëpia Botuese DITURIA, f. 345.

ndaj normës, një ndikuese në vazhdimësi e gjuhës zyrtare. Gjuha zyrtare do të ishte gjuha e informimit, e shkollës, e shqipes për të huaj: e pastër, e rrafshët, e kuptueshme lehtësisht nga të gjithë, e kyçur (për një kohë të papërcaktuar) nga norma. Shkurt, letrarja priret të pasurohet, të jetë e shumëkuptimshme (e nënkuptimshme, e mbikuptimshme, e pakuptimshme, konotuese, e figurshme, pragmatike etj.), e ndryshueshme në vend e kohë dhe në grupe shoqërore, si pasojë e çlirët ndaj normës. Zyrtarja, në të kundërt, priret të jetë e pastër, e njëkuptimshme, unike dhe normative.

Nga pikëpamja sociolinguistike, si gjuha e letërsisë edhe gjuha e administratës kanë një pozicion të lartë se përdoren nga elita e shoqërisë, për pasojë kanë edhe shumë prestigj. Ato bëhen modele përdorimi nga shtresat e tjera të shoqërisë dhe kështu edhe edukojnë gjuhësisht përdoruesit. Te kontekstet letrare, p.sh., kultura, si një përbërës i vendit, kohës, autorit etj., ndihmon në zbërthimin e shumëkuptimësisë, ndërsa në kontekste zyrtare në realizimin e njëkuptimësisë. E ky mund të ishte ai leximi i llojit tjetër, leximi me sy studimor, ku interesat shkencore mund të jenë nga më të ndryshmet. Interesi im shkon drejt vëzhgimit të leksikut të përdorur në të dyja kontekstet. Meqë vetë leksiku mund të vështrohet nga shumë drejtime, çdo vëzhgues i tij nisët nga lënda me të cilën punon përditë dhe ngaqë unë aktualisht jetën akademike e bëj në një Universitet të Kinës, leksiku i semave, rrënjëve, fjalëve kokë e kyç *Kinë*, *kinez*, *kinezçe*, si dhe ai me përmbytje kineze është bërë, për afër dy dekada, një vështrim i përditshëm imi duke u kthyer në përparësi, që, gjithsesi, lidhet me gjuhën shqipe. Duhet thënë se përzgjedhja studimore e këtij leksiku të shqipes lidhet me punën time si mësimdhënës i gjuhës shqipe me studentë kinezë të të tria niveleve të larta të shkollimit. Në këto kushte vëzhgimi i një leksiku të tillë më është dukur me vlera si për shqiptarët, tek të cilët ngjizet një përfytyrim a imazh i paracaktuar nga ky leksik, ashtu edhe për kinezët, kureshtja e të cilëve për gjuhën shqipe do të rritej më shumë kur bëhet fjalë për një leksik që lidhet me vendin e tyre. Kështu, përqendrimi te ky lloj leksiku, në të dyja llojet e zbatimeve të gjuhës standarde shqipe, erdhi e u formësua të unë si një punë studimore për t'ua përcjellë kërkuesve të të dyja palëve. Për arsye të veçorive të dallueshme, analiza e këtij leksiku në gjuhën e letërsisë së autorëve të veçantë shqiptarë dhe e po këtij leksiku në gjuhën e informimit të medias shqipe, është bërë ndaras dhe ky artikull merret me të parën.

Nëse e shtrojmë në kohën tonë, ndër shqiptarë, pyetjen “Çfarë është Kina për ju?”, përgjigja të çon në hullitë që po diskutojmë. Unë e kam bërë këtë pyetje dhe kam marrë përgjigjen që e prisja: “Vend i zhvilluar, por i

**pakuptueshëm...**<sup>4</sup>. Po të supozonim se kjo pyetje do të bëhej para vitit 1990, pavarësisht luhatjeve të aleancës, prapë përgjigjen e hamendësoj në bazë të përgjigjeve të marra në kohën e tanishme; ajo, gjatë nxehtësisë së aleancës, do të ishte: “Vend i madh aleat, por **i pakuptueshëm**” dhe gjatë ftohjes së aleancës: “vend i madh jo aleat, por **i pakuptueshëm**” ku grupfjalëshi i parë i përgjigjes do të ndryshonte në varësi të temperaturave të aleancës, kurse i dyti do të mbetej njësoj si pas pyetjes së bërë. Cilësimi i përbashkët në të dyja kohët (**i pakuptueshëm**) është tashmë stereotipizim i trashëguar, i përmasës kulturore, ndërsa cilësimi i ndryshëm (përkatesisht: vend i zhvilluar dhe vend i madh jo/aleat) ka lidhje me përmasën kohë të kontekstualitetit ose me tematizimin kohor. Përgjigje të tilla të njohura përputhen dhe e gjejnë shpjegimin edhe në diskursin brenda tekstit shqip (letërsi, medie, etj.), ku fjalësi me lëndë kineze ka ngjizur e ngjiz një imazh të paracaktuar duke përvijuar në mendësinë shqiptare një Kinë imagjinare dhe një kuptim të ndryshëm dhe laraman, konotues a figurativ, që buron nga vetë përdorimi i fjalëve që lidhen me vendin, popullin e gjuhën përkatëse, përtej kuptimit të tyre denotues. Episode të jetuara, të lexuara, të rrëfyera në formë qesharakesh apo të ngulitura si idioma e vërtetojnë më së miri këtë dukuri. Në këtë këndvështrim, në përditshmërinë time shqiptare, kam hasur cilësime a përcaktime, paragjykitime, situata qesharake deri në absurd lidhur me emrin e vendit *Kinë*, emrin a mbiemrin *kinez* të banorit dhe ndajfoljen për gjuhën e këtij vendi *kinezçe*. Ashtu si ndajfolja *shqip* p.sh., e ka largësuar deri në mënjanim nga çerdhja e vet semantike përbërësin origjinar *qartësi kuptimore* për arsye të mbulimit fortësisht nga emërtimi i gjuhës; po ashtu, por në kahun e kundërt, ndajfolja *kinezçe*, për arsye të moskuptimit jo vetëm të gjuhës, ndihmuar edhe nga gjedhja e vjetruar fjalëformuese, po e mënjanon kuptimin bazë, në të mirë të *paqartësisë kuptimore* apo *moskuptimit*, duke u kthyer në sinonim stereotipik të pakuptueshmërisë (përdorimin e kuptimit bazë nuk mund ta mohoj), siç ishte sinonim i kuptueshmërisë, në origjinë, ndajfolja *shqip*. Po tregoj nja dy ndodhi gjuhësore të jetuara, ku fjalët e sipërpërmendura nuk merren asnjëherë me kuptimin e tyre të vërtetë dhe, të përdorura si stereotipizma, më mirë etnotipizma, prodhojnë ngërçe në komunikim, për shkak të konotimit që priret të kthehet në denotim:

a) Ndërsa do të shkonim në Kosovë me një linjë shqiptare të fluturimit dhe mbërritëm në Rinas, sipas rregullit ndërkombëtar nja dy ora para nisjes, u rehatuam familjarisht për një kafe. Në bisedë me kamerierin i themi që jemi për Kosovë, por kemi kohë edhe për t’u çlodhur.

Avioni për Kosovë ka ikur, - na tha.

<sup>4</sup> Ndër 100 të anketuar 76 zgjedhën këtë përgjigje për pyetjen se si u dukej Kina e pas viteve ’90 ndër alternativat: vend i pazhvilluar/i kuptueshëm, vend i pazhvilluar/i pakuptueshëm, i zhvilluar/i kuptueshëm dhe vend **i zhvilluar/i pakuptueshëm**.

U ngritëm menjëherë dhe shkuam të interesoheshim. Një zotëri na shpjegoi se avioni u mbush dhe u nis. Kur ne po shpjegoheshim dhe po tregonim biletat, ai na tha:

- Ju **sikur vini nga Kina**, mor zotëri. Si **nuk e kuptoni** që, kur avioni mbushet, nuk ka çfarë pret më, niset.

- Po ne **nga Kina vijmë**, i thashë. Punonjësi, pasi u hutua për një çast dhe e kuptoi se ne **vërtet vinim prej andej**, e mori veten duke thënë se **nuk e kishte në atë kuptim**, por **në kuptimin që ju nuk po merrni vesh** se çfarë po ju them...

b) - Politikanët tanë, në kohë fushate, **flasin kinezçe** me popullin, - më shkruante në fejsbuk një miku im... Në rreshtat më poshtë, pasi ndoshta u kujtua që unë po i shkruaja pikërisht nga Kina, shtoi, disi i detyruar, shpjegimin: - **Ia fusin kot**. Dhe e ndërpreu bisedën.

Ndodhi gjuhësore si këto, që i gjen me shumicë edhe në letrat shqipe, ashtu si për mua, janë e duhet të jenë objekt studimi edhe për studiues të tjerë. Para ca vitesh me një artikull të botuar në revistën “Gjuha jonë”<sup>5</sup>, kemi kërkuar përdorimin e ndajfoljes **kinisht**, të panjohur ose pak të përdorur, në vend të asaj **kinezçe** që është zotëruese në të folur, por mbart paragjykime tek shqiptarët, të cilët e përdorin vend e pa vend për të pakuptueshmen në çdo rrethanë, ashtu siç shpjegova më lart, por edhe në të mirë të formës tjetër **kinezisht** që bën përpjekje të mira për ta specializuar në kuptim, por jo natyrshëm, sepse, në gjendjen e sotme të shqipes, pothuaj të gjitha ndajfoljet e këtij tipi formohen nga emri i vendit me prapashtesën *-(i)sht*, rrallë, më mirë, asnjëherë nga emri i banorit. Pastaj, edhe cilësimet propagandistike, paragjyquese, shakatare, imagjinare apo imazhkrijuese, si *populli vëlla kinez, Kina e madhe, Kina e kuqe, Kina e re, Kina e largët, kinezërira, dragoi kinez, një kinez nga fundi i botës, majmun i verdhë, i ra nga Kina, ciu çërr, superfuqia e dytë, ekonomia e parë, tren që s’kapet* etj. janë ndikues të fortë për formimin e një bote imagjinare, të tejkaluar apo të ardhme, te njeriu shqiptar që nuk e njeh nga afër realitetin kinez. Këto edhe fjalë e shprehje të tjera të kësaj shtrese të leksikut, si në gjuhën letrare, edhe në gjuhën zyrtare, më tërheqin t’i shoh me sy studimor.

Shtresa letrare e leksikut shqip me lëndë e përmbajtje kineze vëzhgohet kryesisht te dy autorë të njohur që e kanë në veprën e tyre tematikën kineze, te Ismail Kadareja me romanin “Koncert në fund të dimrit” dhe te Fatos Kongoli me romanin “Dragoi i fildishtë”, por edhe te të tjerë. Ndërkohë, shtresa informuese e këtij lloji leksiku, shihet veçmas për shkak të veçantive dhe do të jetë objekt i një shkrimi tjetër. Megjithatë, një gjë mund të thuhet që në fillim. Ndarje me thikë në këto dy zbatime hierarkike të gjuhës standarde shqipe nuk

<sup>5</sup> R. Stringa, *Kinezçe, kinezisht apo kinisht*, “Gjuha jonë”, 2001/1-2, f. 81-84.

ka as në këtë shtresë të leksikut të shqipes që duket e vogël. Ka kalime, sidomos nga gjuha e informimit te gjuha e letërsisë, d.m.th. nga poshtë-lart (në kuptimin e vogël - e madhe), ku, për pasojë, fjala zgjerohet të gjithë kufijtë e saj, si në kuptim dhe shenjim, ashtu edhe në normë drejtshqiptimore dhe drejtshkrimore, pra “çlirohet” nga rregullat, por ka edhe kalime të tilla nga lart-poshtë, d.m.th. nga letërsia te lajmi, ku fjala njëkuptimësohet dhe formësohet a fytyrëzohet formalisht, duke u “kyçur” në rregullsi normative, për t’i shpëtuar keqkuptimeve, moskuptimeve, mbikuptimeve dhe nënkuptimeve, aq të dashura për kontekstet letrare. Kalimet me vlera të përkundërta nga strukturat e tërthorta te ato të drejtpërdrejtat dhe anasjelltas do të dëshmonin për përdorues të pakulturuar të gjuhës dhe do ta kthenin letërsinë në lajm dhe lajmin në letërsi. Gjuha e letërsisë me prirje të theksuara pasurimi, ku nuk mungon edhe pastrimi, furnizohet si nga poshtë duke përdorur fondin themelor, ashtu edhe nga anash duke marrë e futur në përdorim fjalë nga gjuhë të huaja (huazime, fytyrëzime dhe prurje), por edhe nga lart, ku vjen në ndihmë fantazia krijuese e autorëve që gjallon neologjizma; kurse gjuha e lajmit me prirje të forta pastrimi, ku nuk mungon edhe pasurimi, njëkuptimëson, rregullon e normëzon format ekzistuese, përzgjedh neologjizmat dhe fytyrëzon, huazon e lë jashtë prurjet e krijuara prej fjalëve të huaja.

Le ta konkretizojmë këtë mendim me këto shembuj:

#### **Fjala Kinë**

- kështu siç paraqitet, është formësuar nga gjuha zyrtare. Po kështu përdoret edhe në gjuhën letrare, por te kjo e fundit ka edhe ca variante që përdoren ende nëpër shprehje, idioma, shakatar, fjalë të prejardhura etj., si: Sina (Sine, Magnus Sinus), Qina, Çinemacin, çini, sini, serikulturë, sinolog<sup>6</sup>, sinologji etj. Gjithashtu, në këtë rrafsh ajo përdoret si fjalë e figurshme, e shumëkuptimshme, me konotacion dhe e hapur ndaj normës:

Eh **Kina** sidoqoftë është një **mister**, kishte vazhduar tjetri. Doni të kuptoni **politikën e Kinës**, ka thënë njëherë **Çu En Lai**, shkoni në **teatrin e Pekinit**... Po ai është plot **simbole të pazbërthyeshme**, majmunë, gjarpërinj... (I.K., Koncert në fund të dimrit, 1990, f. 20)

Përmes personazheve që bisedojnë për Kinën, autori e ka vizatuar atë si një vend të pakuptueshëm (mister). Për t’u bërë më bindës në krijimin e këtij imazhi misterioz citohet përfaqja e ish kryeministrit kinez Kinë-teatër, pas së cilës, si pas blicit të aparatit fotografik, ndriçohet imazhi i vetë Kinës, kur na rrefehet se teatri i Pekinit ishte i mbushur me simbole të pazbërthyeshme.

<sup>6</sup> Sh. Sinani, *Lidhjet historiko-kulturore kino-shqiptare ndër shekuj*, Beijing Foreign Study University, 16 nëntor 2015. Autori sqaron këtu se serikultura merret me kulturën e krimbit të mëndafshit dhe se emri evropian i Kinës në antikitet del në format *Seres*, *Ceres*, *Seres*, *Serindë*, të gjitha me kuptimin *vendi nga vjen mëndafshi*.

Je **Kina**, iu hakërreva (dragoit të vitrinës shën. im R.S.) me një inat të verbër, **Kina e zvogëluar** në përmasat e një hardhuce. (F.K., Dragoi i fildishtë, 2009, f. 140)

Në këtë fragment emri i vendit (Kinë) shenjon dragoin dhe në mënyrë metaforike ndërkëmben tiparet e tyre të kundërta (i/e madh – i/e vogël), për shkak të tipareve përbashkuere (i/e pakuptimtë). Një metaforë e sigurt, ku dragoit i thuhet Kinë e vetë këtij hardhucë dhe, megjithëse kështu personazhi i inatosur e arrin zvogëlimin, prapë Kina mbetet e pakuptueshme.

Djali kthehej nga një **vend i largët**. Në arsenalin e mallkimeve popullore **ai** sendërtohej me shprehjen “Vafsh në **Çinemaçin**”. Mirëpo me gjithë **largësinë e llahtarshme**... (F.K., Dragoi i fildishtë, 2009, f. 51)

... kisha kujtuar se gjendesha **në fundin e botës**, çka nuk qenkej kështu. Siç mësova të nesërmen, fjala **Kinë**, sipas hieroglifëve, do të thotë **Vendi i Mesit**, në kuptimin e mesit të botës. Ndodhesha **pra në mesin e botës**. (F.K., Dragoi i fildishtë, 2009, f. 108)

Në dy fragmentet e mësipërme emri i Kinës i lidhur, në rastin e parë, me largësinë e llahtarshme, deformohet në një përngjitje “pindarike” të mjegullt kuptimisht në shqipe, por me përpjekje përfruese fonetike në mënyrë që grupfjalëshi “Kinë e përtej Kinës”<sup>7</sup> të tingëllojë sa më afër vetë gjuhës kineze dhe, në rastin e dytë, ky emër i lidhur me fundin e botës (shumë larg), shpjegohet nga vetë hieroglifët kinezë si Vendi i Mesit dhe letrarisht mund të ndjehesh jo në Kinë, por në “mesin e botës”. Një rast i qartë, ku në letërsi tjetërimazhi (i shqiptarëve për Kinën) dhe vetimazhi (i kinezëve për Kinën) është diametralisht i kundërt.

- në gjuhën e informimit fjala *Kinë*, ka ndaluar në stacionin e gjuhës shqipe si pjesë e fytyrëzimeve të qëndrueshme që shqipja u ka bërë emërvendeve të huaja duke fituar mbi disa variante të tjera, Qinë dhe Sinë p.sh., të cilat kanë dalë jashtë përdorimit në këtë zbatim, si prurje të huaja dhe përdoren vetëm në letërsi. Përdoret e njëkuptimësuar dhe e normëzuar duke mos lënë shteg për keqkuptim dhe moskuptim:

<sup>7</sup> Sipas mendimit tim duhet të kemi kuptimisht grupfjalëshin “Kinë e përtej Kinës” në shprehjen e përngjitur ose me ndërshtesën –ma- “Çinemaçin”, si te ziemazi, xhuxhmaxhuxh etj. Por, siç shpjeguam, gjuha letrare është hamendësuese dhe jo informuese, aq më tepër që, në rastin konkret, kemi të bëjmë me një lloj idiome, prandaj shprehja mund të shpjegohet edhe ndryshe, mund të jetë e shumëkuptimshme ose e pakuptimshme, ose thjesht një përpjekje përfruese me gjuhën kineze, si te shprehja e njohur e lojërave gjuhësore me fëmijë “Çin çun çau çuni im”. Ndërkaq, një shpjegim interesant për shprehjen në fjalë e kam dëgjuar nga prof. Sh. Sinani, i cili thotë se aty kemi ngurtësimin e shkurtuar të dy toponimeve të largëta me lidhje bashkërenditëse: Çin (Kinë) + e + Maçin (Mançuri).

Në kontinentin europian dhe në pellgun e Mesdheut, rivalët kryesorë të **Kinës** për ndikim ndërkombëtar janë SHBA dhe Bashkimi Europian.

Kryeministri vlerësoi marrëdhëniet tradicionale miqësore mes **Kinës** dhe Shqipërisë, si lidhje të forta që i kanë rezistuar kohërave...

### **Fjala kinez**

- në gjuhën letrare ka përgjithësisht të njëjtën formë me përjashtim të ndonjë rasti qesëndisës, si *qinez* apo të vjetruar si *sinez*. Përdorimi i figurshëm me krahasim si dhe kuptimi metaforik i kësaj fjale paraqiten në rritje dhe jo vetëm po e mbulojnë kuptimin bazë, por ndikojnë edhe në krijimin e një imazhi të dëshiruar të të shenjuarit.

Po unë nuk doja të bindja njeri as për parajsën, as për ferrin **kinez**. (F.K., Dragoi i fildishtë, 2009, f. 54)

E ngacmuar nga një shqiptar **kinezka** paskej thirrur për ndihmë. (F. K., Dragoi I fildishtë, 2009, f. 57)

Është vërtet **mërzi**... do të thosha një **muhabet kinezësh**... (I.K., Koncert në fund të dimrit, 1990, f. 202)

U dukën më në fund fishekzjarrët në formë gjarpërinjsh mitikë **kinezë**... (I.K., Koncert në fund të dimrit, 1990, f. 22)

- në gjuhën zyrtare fjala *kinez* paraqitet e njësuar kuptimisht dhe e normëzuar, por pesha disi e rëndë e përdorimeve të figurshme në letërsi sikur ka ndikuar në llojin zyrtar të komunikimit, çka ndonjëherë vërehet në shqiptimin përdallues dhe në mimikën me nënqeshje a nënkuptim që shoqëron thënien e kësaj fjale. (Çdo dëgjues i vëmendshëm dhe vëzhgues i imtë i fytyrës, si element i rëndësishëm i komunikimit njerëzor, do t'i ketë vënë re këto shenja, që në të shkruar jepen mes thonjzash.)

Autori **kinez** Mo Yan duke firmosur foton e tij.

Për të lehtësuar këtë proces **kinezët** kanë planifikuar hapjen e bankave të tyre në disa vende të Europës...

Është vetëm njëri prej qindra-mijëra miqve të “popullit **kinez**” që për dhjetëra vjet me radhë vazhdojnë të mblidhen së bashku...

### **Fjala kinezçe**

- në këtë formë mbërrin në gjuhën letrare nga gjuha e folur. I ka apo i merr lehtësisht të gjitha ngjyrimet e mundshme kuptimore dhe të figurshme (e ndihmuar edhe nga prapashtesa *-çe*); paraqitet e ndryshme nga tipi i zakonshëm fjalëformues (emër vendi + prapashtesa *-(i)sht*) dhe, për këtë arsye, ndeshet e lëkundur semantikisht dhe e dyzuar formalisht<sup>8</sup>. Në strukturë paraqitet ndryshe nga ndajfoljet dhe emrat që shënojnë gjuhë të tjera:

<sup>8</sup> Kështu ndodh edhe në gjuhën angleze, po t'i referohemi *Fjalorit anglisht-shqip* të Pavli Qeskut. Në zërin Chinese në kuptimin *gjuhë* ai zgjedh si përgjegjëse shqipe tre forma: *gjuhë kineze*, *kinezishte*, *kinezçe* duke shpjeguar edhe shprehjet: *to speak*

... dikush ... këmbënguli të formuloja në **kinezçe** disa nga **sharjet më të ndyra të gjuhës shqipe**. (F.K., Dragoi i fildishtë, f. 51)

**Kinezçja** e tij... Sa **tallje, të qeshura e thumba** kishte duruar ai midis njerëzve të rrethit të vet për shkak të asaj **kinezçjeje**. (I.K., Koncert në fund të dimrit, 1990, f. 140)

Këto ia përsërita në **kinezçe, rusisht dhe frëngjisht**. (F.K., Dragoi i fildishtë, f. 286)

- në gjuhën informuese, kjo formë (*kinezçe*), e zbritur nga gjuha letrare, ka filluar me kohë ta ndjejë shumëkuptimësinë dhe konotacionin dhe për këtë janë bërë përpjekje për diferencim kuptimor fillimisht me formën *kinezisht*, e pastaj me atë *kinisht*. Të dyja këto forma e kryejnë pa asnjë ngjyresë të tepërt funksionin informues, ndërkohë që e para përdor një model fjalëformimi jo prodhimtar në shqipe (emër banori + *isht*), sipas të cilit duhet të kishim *anglezisht, spanjollisht apo japonezisht*, kurse e dyta nuk është dhe aq e përhapur. Një gjë e tillë ka ndodhur në mënyrë përfundimtare me ndajfoljet *turqisht* dhe *turçe* dhe është duke ndodhur me ndajfoljet *kinezisht/ kinisht* dhe *kinezçe* (shih shën. 7)

Mund të dëgjosh edhe **kinezçe** në apartamentin e tij, pasi jo vetëm ai, por edhe e shoqja, Laureta, flet **gjuhën kineze**.

Në Shqipëri ka 200-300 **kinezçefolës**, kurse Shoqata e Miqësisë me Kinën ka afro 350 anëtarë.

...deputeti i Partisë Socialiste Fidel Ylli ka ironizuar kryeministrin Berisha duke kënduar një këngë në **gjuhën kineze**.

Fjalor **kinezisht-shqip**

Berisha: **Kinezishtja**, gjuhë e dytë në shkolla

Libër Bashkëbisedimesh Shqip-**Kinisht**

Nëse të gjitha fjalët, madje edhe format dhe kuptimet e mundshme të leksikut të një gjuhe, prandaj edhe ato të shtresës që po studiojmë, arrijnë të gjejnë vend në gjuhën e letërsisë, nuk duhet të ndodhë kështu në gjuhën e informacionit.

### **Fjala kinezëri**

- disa e marrin me konotim pozitiv, disa me negativ. Sa herë ajo përdoret, ndihet nevoja të sqarohet. Është një fjalë që i përket gjuhës së letërsisë, sepse me anë të saj mund të krijosh figuracion dhe të ndërtohet imazhet përkatëse, por edhe sepse fjala të lejon t'ia analizosh kuptimin pragmatikisht sipas përdoruesve të thënieve që e përmbajnë dhe sipas kohës, vendit dhe kulturës. Me të mund të komunikosh në mënyrë të tërthortë, por jo të informosh drejtpërsëdrejti, ndaj nuk i gjenden shpjegime pak a shumë të njëjtësuar, nuk zhvishet lehtë nga konteksti dhe nuk është fjalë denotuese

---

*Chinese* me dy mënyra në shqipe: *flas kinezçe, flas gjuhë të pakuptueshme* dhe *It's Chinese to me: për mua është turçe*.

fjalori. Fjala *kinezëri*, në shqipe dhe jo vetëm këtu, përgjithësisht, përdoret për të treguar vogëlsira dhe punë dore të imta si dhe një lloj të veçantë veprimi a sjelljeje. Në përdorimin ideologjik, të ngulitur tashmë në shqipe mund të jetë futur fillimisht nga politika, herë në kontekste pozitive e herë negative, duke pasqyruar kështu edhe temperaturat e marrëdhënieve kino-shqiptare, pastaj artistë të fjalës i kanë bërë vend nëpër vepra letrare duke ia përthyer edhe më tepër kuptimësinë kontekstuale, për ç'arsye ajo e ka të vështirë të gjejë hapësira përdorimi në gjuhën informuese. Kështu, me përdorimin e kësaj fjale nga studiuesi dhe gazetari Ilir Yzeiri, u hap një debat i madh, kur ai botoi artikullin e tij "Intelektualët dhe një ambasador i vogël i një vendi të madh" në gazetën "Shekulli" më 9. 04. 2011 dhe filluan sakaq të shfaqen nëpër forume shumë përkufizime të fjalës, me dëshirën për të arritur te kuptimi i vetëm i saj, te kuptimi parësor, shënues. Një shpjegim dhe sqarim e ka dhënë edhe vetë autori në "Dr. Ilir Yzeiri: Gabohesh, zoti Ambasador Arvizu":

Unë e di që gjithë kjo ka ardhur për shkak se unë, një sjellje të ambasadorit Arvizu, e kam quajtur «kinezëri».

Nuk e di se si e kanë përkthyer këtë fjalë ndihmësit tuaj shqiptarë, por më lejoni t'ju them se kjo fjalë nuk ka asnjë ngarkesë ofensive, ajo është një shenjë që karakterizon një mënyrë të sjelljes dhe ka hyrë në gjuhën shqipe nga koha e marrëdhënieve tona me kinezët. Ju duhet ta dini, e nderuar zonjë, se ne kemi qenë për 20 vjet të lidhur me Kinën komuniste dhe, nën shembullin e Kinës, u bart edhe këtu te ne Revolucioni famëkeq Kulturor dhe u nxit ndërtimi i njeriut të ri. Këtu te ne botoheshin si libra xhepi, citatet e Kryetarit Mao që ishin tekste propagandistike pa asnjë vlerë dhe shpeshherë qesharake. Ato thoshin p.sh., se «njeriu duhet ta dojë partinë», «partia mbi të gjitha», apo lloj-lloj citatesh që shpeshherë shkaktonin të qeshura. Kulmin p.sh., e pati arritur një kinezëri që ishte një amalgamë e Konfucit dhe e thëniesve të Maos që thoshte: «Koha më e mirë për të larë enët është pas buke».

Brezi im është rritur, si me anën dramatike të kinezërive, si edhe me anën komike të tyre. Kështu që në ligjërimin shqiptar fjala «kinezëri» ka hyrë si një shenjë që shënjon një sjellje populiste, propagandistike dhe pa asnjë vlerë si lajm, apo si ngjarje. Mua m'u duk se historia që tregoi ambasadori me atë gruan që i përkëdheli fëmijën, pra përpjekja e tij për t'u shfaqur popullor ishte e shtrënguar dhe ngjante me kinezëritë e kohës së Mao Ce Dunit. Unë do të prisja që për këtë përdorim të kishte reaguar Ambasada e Republikës së Kinës, por jo ajo e SHBA-ve. Megjithatë, në qoftë se ju këtë interpretim timin e kini përjetuar si tepër ofensiv, unë e tërheq dhe në asnjë rast tjetër nuk do ta përdor më.<sup>9</sup>

<sup>9</sup> <http://www.forum-al.com/showthread.php?t=16793>

Ja përdorimi i shumëdebatuar i fjalës *kinezëri* në artikullin e sipërpërmendur, që u pa si klishe, shprehje raciste etj., dhe që i drejtohej ambasadorit amerikan të asaj kohe në Shqipëri, Arvizu:

Nga ana tjetër, nuk është e gjetur përpjekja që bëni ju për t'u treguar se jeni një njeri i dashur me popullin. Këtyre në shqip ne u themi **kinezërira**. Ju e njihni mirë psikologjinë e **kinezëve të Maos** dhe heroin **Lej Fen**. Ju mund të lexoni edhe romanin "Koncert në fund të dimrit" të shkrimtarit tonë të madh Kadare. **Atje vizatohet bukur ajo që ne i themi kinezëri**. Në fakt, ... historia që treguat ju me atë gruan me fëmijën që ju e takuat dhe përkedhelët edhe fëmijën, të më ndjeni, po nuk ishte e gjetur. Ky lloj populizmi në Shqipëri nuk ngjit, përkundrazi bën efekt të kundërt.

Ja dhe një nga përdorimet e Kadaresë për këtë fjalë në romanin e tij me tematikë kineze:

... këtu as fjala nostalgji s'ka kuptim, por duhet thënë më mirë **amatori e kinezërive**. Pra kjo **amatori** është e përçudnuar, sepse s'ka lidhje me **Kinë**n, me **popullin** apo **artin kinez** e të tjera gjëra si këto, por buron nga motive të ulta, që ndodhen në vetë qenien... (I. Kadare, Koncert në fund të dimrit, 1990, f. 147-1480)

Fjala *kinezëri* është një metaforë e ngurtësuar në mënyrë të cunguar në shqipe, që, gjithsesi mbart në semantikën e vet një kontekst të caktuar shumëpërmasor dhe nuk mund të nxirret jashtë këtij konteksti me gjithë përpjekjet që bëhen duke mbetur kështu, më tepër se semë, një përcaktim përgjithësues e homogjenizues. Edhe pse fjala e ka kaluar periudhën historike të cungimit kuptimor dhe është bërë një etnotipizëm, i lidhur me kinezët duke «infektuar» edhe fjalë në rrezen e saj. Kështu ajo përhap paragjykim më tepër se informacion dhe në këtë mënyrë mund të paragjykojë edhe vetë përdoruesin. Meqë, si gjuha e letërsisë edhe ajo e informacionit, janë pjesë e komunikimit dhe vetëm mënyra e përcjelljes së mesazhit (tërthoras-drejtperdrejt) i dallon, atëherë ndoshta propaganda a pragmatizmi i përcjellësit të mesazhit mund të jenë arsyet e përzgjedhjes së kësaj fjale në media.

Duke vëzhguar materialin faktik që lidhet me gjuhën dhe vendin e Kinës në dy romanet e përmendura, dhe më gjerë, dallojmë fjalë me origjinë kineze ose *kinizma* dhe fjalë a shprehje shqipe me përmbajtje kineze ose *kalkime nga kinishtja*.

Procesi i huazimit të një fjale ose të një shprehje nga një gjuhë tjetër duke ruajtur kuptimin por duke zëvendësuar përbërësit me elementë morfologjikë të gjuhës vendëse, pra është një tip huazimi, në të cilin çdo morfemë ose fjalë përkthehet me morfemat ose fjalët barasvlerëse të gjuhës tjetër. *Kalkimi* mund të konsistojë në një fjalë, frazë ose edhe në një fjali të shkurtër. *Fjalët e kalkuara quhen kalke*. P.sh., fjala angleze *almighty* dhe fjala shqipe (*i*) *plotfuqishëm* janë *kalke* nga

latinishtja *omnipotens* (lat. *omni* + *potens*, ang. *all* + *mighty*, shq. *plot* + *fuqi*). Shprehja kantoneze *yiht gáu* është *kalkim* i shprehjes angleze *hot dog* (*yiht* = *hot*, *gáu* = *dog*). Shprehja angleze *beer garden* and *academic freedom* është *kalkim* i gjermanishtes *Bier-garten* and *akademische Freiheit* (*Birrari e hapur dhe liri akademike*).<sup>10</sup>

Kinizmat janë më të pakta nga numri dhe përgjithësisht hyjnë në shqipe si *fytyrëzime*<sup>11</sup> të drejtpërdrejta (*çjentinçi*) ose me ndërmjetësinë e një gjuhe të tretë si japonishtja në këtë rast (*rikshi*), duke iu përshtatur sistemit paradigmatico-sintagmatik të saj dhe duke jetuar si fjalë shqipe. Kuptimisht ato përfshijnë onomastikën, kuzhinën, veshjen, politikën, ekonominë, teknologjinë etj., dhe janë:

a) emra të përveçëm onomastikë:

- antroponime ose emra njerëzish, si *Mao Ce Dun*, *Çu En Lai*, *Çian Çin*, *Lej Fen*, *Vang Mei*, *Sui Lin*, *Lu Sin*, *Siao Hua* etj.
- toponime ose emra vendesh, si *Kinë*, *Pekin*, *Tiencin*, *Nankin*, *Shangai*, *Hanxhou*, *Van Fu Xhin*, *Tiencin*, *Tien An Men*, *Pei Hai*, *I He Jyen* etj.

Këto emra janë dhënë në shqipe nëpërmjet rregullimit fonetik përgjithësues të formës së dëgjuar drejtpërdrejt nga gjuha kineze, ndërsa ato tradicionalet me rregullim të formave të dëgjuara nga gjuhë të ndërmjetme (*Kinë*, *Pekin*, *Kanton*, *Mao Ce Dun*, *Lej Fen* etj.). Meqenëse sot, për shkak të kontakteve të drejtpërdrejta, po përjashtohet gjithnjë e më shumë gjuha e ndërmjetme, kanë filluar të lindin në shqipe dysorë të tipit *Pekin-Beigjin*. Ky grup leksemash është kontakti i parë i fjalës kineze që natyralizohet ose fytyrëzohet, duke çelur shteg ecurie edhe për fjalë të tjera që nga nevoja të ndryshme bëhen pjesë e leksikut vendës përmes fytyrëzimit<sup>12</sup>.

Ja ca shembuj:

... mendonte se mund të gjendej ndonjë ditë përballë **Mao Ce Dunit?**  
(Koncert..., f. 179)

Dhe i isha mirënjohës **Lu Sinit** që më kishte ngritur një perde të **Kinës**.  
(Dragoi..., f. 307)

<sup>10</sup> J. C. Richards, Longman *Dictionary of Language Teaching & Applied Linguistics*, English-Chinese Edition 1998, f.270/ **loan translation** (Përkthimi im R. S.).

<sup>11</sup> J. C. Richards, Longman *Dictionary of Language Teaching & Applied Linguistics*, English-Chinese Edition 1998, f.303/ **nativisation** (Përkthimi im R. S.).

*Përvetësmi i fjalëve të huaja në një gjuhë të caktuar. Fytyrëzimi i shndërron fjalët e huaja në huazime duke i bërë pjesë të fondit të leksikut indogjen.*

Për më tepër: Berg 1993, Kachru 1981.

<sup>12</sup> R. Stringa, *Fjalë të huaja - huazime dhe prurje*, “Kërkime gjuhësore”, IV, Tiranë, 2016, f. 129-134.

Mund ta çoja në ndonjë lokal, fjala vjen në restorant “Moska”, pranë **Tung U Jenit**. (Dragoi..., f. 248)

...një tjetër dragua do ta kisha gjetur, të ngjashëm me monstrën e fildishtë të **Bai Hua Ta Lout**. ((Dragoi..., f. 147)

... parkun **Tao Zhan Ting**... sipas **Siao Huas** atje mblidheshin njerëz të parrezikshëm. (Dragoi..., f. 250)

Një ditë të tërë madje u enda rrugëve të **Pekinit** si idiot, hip e zrit trolejbuzëve, nga **Pei Hai** në **I Hë Jyen**, nga **Tien An Meni** në **Tao Zhan Ting**, nën një diell përvëlues... (Dragoi..., f. 252-253)

b) Fjalë të përgjithshme, sidomos emra të fushave kuptimore të ndryshme, ku shtegu i çelur nga emrat e përveçëm fillon e zbatohet edhe te ato fjalë që autorëve u duken të nevojshme a për të krijuar imazhe, a për mungesa në leksikon vendës. Ato janë fjalë të sferave të tilla, si:

- festa, përshëndetje/urime, pije/duhan, etj., si: *Çhun Çie, niha, çin çin, Gan pei, çaj, muotaj, (cigare) Xhung Hua* etj.;
- kuzhinë, si: *çini, keçap, toufu, liçi* etj.;
- moda/veshja, para etj., si: *qipao, jaka Mao, gejshë, jen, juen* etj.;
- filozofi, poezi, histori, si: *jin-jang, fengshuej, hajku, han, gomindan*;
- politika, si: *Çunanhai, bao gao, Zhen Min Zhi Bao, dacibao*;
- ekonomia/teknologjia, natyra etj., si: *rikshi, çjentinçi, tajfun, tufan*;
- sporti, si: *qigong, tajçi, xhudo, kunfu, taekwondo*.

Për shembull:

Inkursioni im i parë në **Van Fu Xhin** qe një zhgënjim katastrofik. Zbrita nga **trolejbusi** me ngrefosjen e një **xhentelmeni** të veshur **shik**, çka më jepte ndjesinë e një përparësie racore, veçanërisht kur një pjesë të rrugës e përshkova me **rikshi**. (Dragoi..., f. 111)

Përveç kinizmave fragmenti i mësipërm ka edhe anglicizma, të cilat janë në vendin e duhur dhe fotografojnë mjedisin e karakterin si me aparat fotografik. Ato gjithashtu janë model shkrimi për fytyrëzimet nga kinishtja.

Që merrte apo s'merrte pjesë në **bao gaot** javore..., kjo nuk e pengonte të ishte student i shkëlqyer. (Dragoi..., f. 275)

Kinizmat, pra fytyrëzimet shqipe të fjalëve kineze shfaqin nevojën e shqipes për pasqyrimin sa më të përpiktë të një mjedisi kinez, ndërsa kalkimet nga kinishtja (*Muri i Madh*, p.sh.) edhe dëshirën e autorëve për kontekstualizim vendor, kohor dhe kulturor të semantikës së modeleve strukturore kineze. Këto modele përfshijnë nga poezitë kineze, citatat politike e deri te emërtimet e thjeshta dhe të përbëra vendëse. Kalkimet, d.m.th. modelet strukturore kineze të përkthyer në shqipe janë më të shumta dhe lidhen me sfera nga më të ndryshmet të jetës shoqërore, si:

- a) politika: *revolucioni kulturor, gardistët e kuq, lindja është e kuqe*;

- b) ekonomia: *ura të betonta ajrore*;
- c) historia: *ushtarët prej argjili në përmasa natyrore*;
- d) arti e sporti: *ekspozita e poçerisë kineze, Opera e Pekinit, grupi skulpturor “Oborri i vjeljes së taksave” Opera “Marrja me dinakëri e Malit të Tigris”*;
- e) moda e veshja: *këpucë-pandofla*;
- f) ushqimi e kuzhina: *Rosa e Pekinit*;
- g) emërtime të përbëra: *Porta e Qetësisë Qiellore, Hotel “Paqja”, Tempulli i Qiellit, Muri i Madh Kinez, Viti i Ri Kinez*;
- h) citate, poezi: *fshati rrethon qytetin, një shtet dy sisteme*.

Për shembull:

Unë e doja. Dhe ajo më donte. Dhe s’kishte arsye të trembeshim. Do t’ia mbushja mendjen të shkonim në mes të sheshit “**Tien An Men**”, të shpalleshim hapur. Ose jo, sheshi “**Tien An Men**” s’qe fort i përshatshëm, më mirë të shkonim në **Tempullin e Qiellit**. Atje, në **murin rrethor magjik**, do t’i pëshpërisja me buzët pranë tullave të lëmuara e në anën e kundërt, në pikën diametralisht të kundërt me mua, ajo do të dëgjonte si në telefon, do të më kthente përgjigje. Fjalët e saj do rrëshqisnin faqes së murit për të ardhur në veshin tim: Nuk është iluzion, nuk është! (Dragoi..., f. 60)

I gjithë ky tekst është një paraqitje me fjalë shqipe e një përmbajtjeje kineze për një nga pikat turistike të qytetit të Pekinit, prandaj nuk mund të mungonin këtu kinizmat dhe kalket.

Më përfytyro të sëmurë me grip. Endrra në “**Pallatin e Kuq**”, variant i botuar dyqind vjet të shkuara, në kohën e perandorit **Qiang Long**, ka një episod kur **Qing Veni**, besoj të kujtohen personazhet, vuante nga një marramendje për shkak të hundëve të zëna. **Bao Ju** urdhëron **She Jyenë** t’i jepte atij për të honepsur pak tabako të ardhur nga perëndimi. I sëmuri teshtin gjatë dhe shërohet. Të marrim, pra, edhe ne pak tabako perëndimor, si **Qing Veni** dyqind vjet të shkuara, në kohën e perandorit **Qing Long të dinastisë së Mingëve**. Të teshtijmë, edhe ti, edhe unë. Me një teshtimë të fortë, të rëndë, sa të tronditet **Muri i Madh**. (Dragoi..., f. 101-102)

Një tregim kinez i përkthyer në shqip nuk ka se si t’i shpëtojë fjalësit kinez. Mes kinizmave onomastike përdoren aty edhe kalkimet *Pallati i Kuq, Dinastia e Mingëve dhe Muri i Madh*.

...më tregoi numrin e fundit të një reviste në kopertinën e së cilës paraqitej **Mao Ce Duni** duke kapërcyer me not **Lumin e Verdhë** apo **Jan Ce**. (Dragoi..., f. 260)

Madje në të njëjtën fjali, si më lart, për emërtime lumenjsh përdoren edhe kalkimi *Lumi i Verdhë*, edhe kinizmi *Jan Ce*.

Ku tjetër fjalët “**perandori e qendrës**” mund të shijoheshin më mirë se këtu? (në shpellë, shën. im R.S.) (Koncerti..., f. 30)

E kishte mbyllyr njërin sy për nazet e tyre gjatë **Revolucionit Kulturor, për gardistët e kuq**, për Shekspirin e dhjetëra **vogëlësira**. (Koncerti..., f. 33)

Figuracioni me fjalët shqipe të shtresës së leksikut të marrë në shqyrtim në këtë punim, d.m.th. të atij me brumin kinez mund të shihet edhe si një rrafsh i lëmuar pasqyruar për krijimin e një imazhi për Kinën, i cili mund të jetë fotografik, fantastik, propagandistik, pragmatik, etj. Ndryshe nga kinizmat dhe kalkimet, imazhet kineze me fjalë shqipe më tepër se pronë e gjuhës janë përdorime kontekstuale të lidhura ngushtësisht me kohën, vendin, kulturën dhe personin që i prodhon. Kjo është një çështje që i përket imazhologjisë, të cilën do të kemi rast ta trajtojmë hollësisht në shkrime të tjera. Këtu vetëm sa po japim ndonjë shembull se si krijohet ky imazh përmes pasqyrës së këtij lloj leksiku:

Dhe Besnik Struga i kishte treguar Silvës se si një mbrëmje feste, pikërisht mbrëmjen e festës së parë pas prishjes (me BS, shën. im R.S.), kur të gjithë prisnin të shikonin **fishekzjarrët e porsambërritur nga Kina**, për të cilët kishte ditë që flitej, ai ishte ndodhur në rrugë tamam në kohën kur **qielli ishte mbushur prej tyre**. Njerëzit kishin ngritur kokën përpjetë **të gëzuar dhe të habitur njëkohësisht** për këta **fishekzjarrë, që duhet thënë se ishin të ndryshëm** nga ata që kishin parë më parë, ca fishekzjarrë gjithësesi **të huaj, me një ngjyrë të verdhame**, që lëshonin tek binin **ca cijasje ngjethëse** sikur t’i flisnin njëri-tjetrit: ç’është kjo tokë, atje, këtu, poshtë... Dhe sikur të mos mjaftonte kjo, pas shpërthimeve të njëpasnjëshme u dukën më në fund **fishekzjarrët në formë gjarpërinjsh mitikë kinezë**, që vareshin të fundit, bënin valëvitje në erë, gjersa fikeshin njëri pas tjetrit duke e lënë qiellin **krejt të zi**. Njerëzit nisën të thërrisnin: “**Gjarpërinj, gjarpërinj!**” dhe unë me drithërimë në zemër mendova: Ç’është kjo gjë **ogurzezë?** (Koncerti... f. 22)

Parashikimi, me pyetjen “Ç’është kjo gjë ogurzezë?”, i prishjes së marrëdhënieve me Kinën që në embrion, në paragrafin më sipër, bëhet jo vetëm me risjelljen e simbolit të gjarpërit që personazhit i ishte shfaqur në kohën e prishjes me Bashkimin Sovjetik, por edhe me fjalët e përdorura, të zgjedhura enkas me aliteracionin e bashkëtingëlloreve *cc ss (cacijasjengjethese)* që ndërmendin si zhurmën bezdisëse të fishekzjarrëve, edhe gjuhën e vendit prodhues të tyre, duke synuar kështu imazhin me figura zgjatimesh të verdhame dhe me zëra pickues të simbolit gjarpëror të prishjes që ndillej të përsëdytej.

Një spektakël me **xhonglerë të stisur, dragoj të frikshëm**, që hynin e dilnin nën **gjënimet shurdhuese të gongut dhe pjatave të metalta**,

me luftëtarë të fshehur pas maskash groteske tmerruese tërë ngjyra, flamuj e xhingla, që vringëllinin armët e dialogonin me njëri-tjetrin me zë të hollë tërë kadenca të pabesueshme. (Dragoi..., f.288)

Edhe po të mos kesh qenë spektator, përshkrimi me fjalë, në fragmentin e mësipërm, është piktura më e gjallë që mund t'i bëhet shfaqjes së Operas së Pekinit.

Imazhin fantastik në rastin e parë dhe fotografik në të dytin, i bashkon ideja e krijimit të përfytyrimit për një botë të pakuptueshme. Ky mendim përforcohet sepse fjalët, format e fjalëve dhe grupfjalëshat apo shprehjet me denduri më të madhe përdorimi në dy veprat e marra në analizë janë ato të kokë- dhe kyç-fjalës *kuptim* me vlerë mohuese.

## SUMMARY

### KINISMS AND CALQUES WITH CHINESE CONTENT IN ALBANIAN LITERATURE - IN THE THE NOVELS "CONCERT..." (I. KADARE) AND "DRAGON..." F. KONGOLI ETC.

From the sociolinguistic point of view, both the language of literature and the language of administration have a high position that are used by the elite of society, and consequently have a lot of prestige. They become models of use by other segments of society, and in this way educate users linguistically. And exactly this could be the reading for studies, where scientific interests can be of the most varied. My interest goes towards observing the lexicon used in both contexts. Since the lexicon itself can be viewed from many angles, each of its observers starts from the subject with which it works daily, and because I currently do academic life at an University of China, the lexicon of sememes, roots, keywords: China, Chinese language, Chinese persons, as well as the lexicon with Chinese content has become, for nearly two decades, a daily look of mine becoming a priority, which, however, is related to the Albanian language.

It must be said that the study select the Albanian lexicon related to my work as a teacher of the Albanian language with Chinese students of all three high levels of education. In these conditions, the observation of such a lexicon has seemed valuable to me, both for Albanians, who conceive a concept or image predetermined by this lexicon, as well as for the Chinese, whose curiosity about the Albanian language would increase more when it is a lexicon related to their country. Due to distinct features, the analysis of this lexicon in the language of literature of special Albanian authors and the same lexicon in the formal language of the Albanian media, has been done separately and this article deals with the first.

The literary layer of the Albanian lexicon with Chinese subjects and content is observed mainly in two well-known authors who have in their work the Chinese theme, Ismail Kadare with the novel “Concert at the end of winter” (1988) and Fatos Kongoli with the novel “The Ivory Dragon” (1999), but also in others. Meanwhile, as above mention, the formal layer of this type of lexicon is seen separately due to its peculiarities and will be the subject of another article. The language of literature is supplied from “below” using the basic fund, as well as from “the side” by taking and using words from foreign languages, but also from “above”, where the creative fantasy of authors creates neologisms; whereas the formal language unifies forms and meanings, regulates and normalizes them, selects neologisms and borrows, and excludes the confusable forms created by foreign words.

Observing the factual material related to the language and place of China in the two novels mentioned, and beyond, we distinguish words of Chinese origin or phonetic loans (kinisms) and Albanian words or expressions with Chinese content or loan translations i.e. calques from Chinese.

Albanian phonetic loans (kinisms) of Chinese words (e.g. *qipao*), show the need of Albanian language for the most accurate reflection of a Chinese environment, while the loan translations (calques) from Chinese (e.g. Muri i Madh) show the author’s desire for local, temporal and cultural contextualization of semantics of Chinese structural models. These loan translations range from Chinese poetry, political quotes, and simple and compound local names. Translated into Albanian calques are more numerous than kinisms and both of them are related to different spheres of social life.

